



ARGUMENTUM

news opinion analysis



Kina ME RUSINË dhe Europa PA SHBA-të!

- A është takimi Trump-Putin një "Jaltë 2.0"?

- Si e mban Beogradi nën kontroll politik komunitetin serb në Kosovë

- Pse "hesht" Kina?

Të dashur lexues dhe ndjekës të Argumentum.al,

Argumentum.al tashmë nga muaji prill 2022 vjen në versionin e një reviste të përmuajshme politike-diplomatike të cilën mund ta shfletoni online.

Ky botim mujor ofron një kombinim të qartë të lajmeve në vend, rajon dhe botë, si dhe opinioneve dhe analizave për ngjarjet e zhvilluara përgjatë një muaji.

Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në Vend, Rajon, Europë dhe në Botë.

Argumentum.al përpiqet të jetë burim autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare,

politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpunorëve të tjerë vendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë Argumentum.al është e hapur për komente e mendime të lexueseve të saj.

Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revisten Argumentum.al në shqip dhe anglisht!

“Argumentum”, një proces intelektual ...

Marjana DODA
Kryeredaktore

Përmbajtja

03 EDITORIAL

- A është takimi Trump–Putin një “Jaltë 2.0”?

05 OP/ED

- Kina ME Rusinë dhe Europa PA SHBA-të!

- Pse “hesht” Kina?

10 JO VETEM LAJM

- Vuçiqi po e shtyn Serbinë drejt një konflikti civil.

- Fitoret taktike në bisedimet e paqes në Ukrainë do të çojnë vetëm në humbje strategjike.

15 FOKUS

- Bota vazhdon si zakonisht – në mënyrë të paparashikueshme.

- Si e mban Beogradi nën kontroll politik komunitetin serb në Kosovë.

18 REALPOLITIK

- Alaska si kabanë alarmi për Europën!

20 POLITIKË

- Trump letër Presidentit Begaj: Pres me padurim të vazhdojmë punën tonë të përbashkët për të ndërtuar një të ardhme më të sigurtë, më të fortë dhe me të sukseshme.

- Kryeministri Rama reagon pas protestës për lirin e ish-

krerëve të UÇK: Pse Kuvendi i Kosovës nuk ngre zërin me një rezolutë, pa dallime partish?

21 BOTA

- Speciale/ Shtëpia e Bardhë sinjalizon mbështetje për garanci sigurie për Ukrainën – Trump i hap rrugën bisedimeve të paqes me Putinin dhe Zelenskyn.

ENGLISH EDITION

24 ENGLISH TOP NEWS

- “Council of Albanian Ambassadors condemns Gaza operation, calls for two-state solution”.

25 OP/ED

- The Americans In, the Russians Down, and the Iranians Out: The Regional Impact of the Armenia- Azerbaijan Peace Agreement.

27 IN FOCUS

- International recognition of Palestine: Political marketing or genuine change?

29 REALPOLITIK

- Alaska, a bell toll for Europe! No trade partners but adversaries! Palestina and the two states solution! When Pristina drowns in a spoonful of water!

A ËSHTË TAKIMI TRUMP-PUTIN NJË “JALTË 2.0”?



Kur dëgjojmë fjalën *Jalta*, menjëherë na vjen ndër mend imazhi historik i tre liderëve të mëdhenj botërorë e vitit 1945, ku Roosevelt, Churchill dhe Stalin ndanin botën pas Luftës së Dytë Botërore. Ishte një moment vendimtar që vendosi fatet e shumë kombeve pa praninë e tyre në tryezën e negociatave. Ndër zërat që mungonin në atë kohë ishte edhe ai i Francës, dhe bashkë me të, interesi më i gjerë i Europës kontinentale. Sot, kur Presidenti Trump përgatitet të takohet me Presidentin Vladimir Putin në Alaskë,

rikthehen frikërat për një Jaltë të dytë, këtë herë pa përfaqësim europian dhe pa ndonjë aktor tjetër që të balancojë diskutimet. Takimi është planifikuar të ndodhë pa dëshmitarë, me një bisedë kokë më kokë midis dy liderëve. Deklaratat paraprake të Trump, që përmendin “shkëmbime tokash” në Ukrainë, kanë rritur ndjeshëm shqetësimin në kryeqytetet europiane.

Diplomacia e fshehtë dhe marrëveshjet dypalëshe mbi territore të tretë janë pikërisht ajo që George Kennan e paralajmëroi si rrezik – “rreziku më i madh është që ne të kthehemi në njësoj si ata me të cilët përballemi.” Takimet

Në vitin 1945, tre superfuqi formësuan botën e pasluftës. Sot, nëse Trump dhe Putin tentojnë të riformatojnë rendin botëror përmes një takimi të mbyllur, mungon një element kyç: një aktor i tretë që përfaqëson fuqinë globale të së tashmes. As Europa dhe as Kina nuk janë përfshirë në këtë kornizë diskutimi megjithëse të dyja janë thelbësore për një rend të qëndrueshëm ndërkombëtar.

e mbyllura, si ai i mundshëm Trump-Putin, shkojnë në drejtim të kundërt me transparencën dhe legjitimitetin që kërkon një rend i drejtë ndërkombëtar. Por a mund të quhet ky takim një *Jaltë 2.0*?

Mungesa e një rendi shumëpalësh

Në vitin 1945, tre superfuqi formësuan botën e pasluftës. Sot, nëse Trump dhe Putin tentojnë të riformatojnë rendin botëror përmes një takimi të mbyllur, mungon një element kyç: një aktor i tretë që përfaqëson fuqinë globale të së tashmes. As Europa dhe as Kina nuk janë përfshirë në këtë kornizë diskutimi megjithëse të dyja janë thelbësore për një rend të qëndrueshëm ndërkombëtar.

Europa mbetet në periferi të kësaj skene. Britania e Madhe është

shtyrë gjithnjë e më shumë në periferi nga politika e jashtme e Trump. Ndersa Franca, pavarësisht përpjekjeve të dëshpëruara të Macron për të qenë pjesë e peizazhit global, nuk arrin të imponojë peshë të mjaftueshme. Gjermania, edhe pse sot një fuqi ekonomike e madhe dhe politikisht më e balancuar, mbetet jashtë loje në këtë konfigurim strategjik që Trump projektton. Europa, për Trump-in, nuk është një palë me të drejtë fjale në tavolinën globale, është më shumë një fushë loje shahu, gurët e secilës i leviz Trump. Madje në këtë rast Vladimir Putin.

Kina – aktori që mungon në tavolinë

Nëse dikur Kina u la jashtë tryezës së Jaltës pavarësisht kontributit të saj në luftën e Dytë Botërore, sot një përjashtim i saj është i pakuptimtë dhe i rrezikshëm. Kina e vitit 2025 nuk është thjesht një fuqi rajonale. Kina e sotme është një fuqi ekonomike globale, e pakontestueshme, dhe një aktor kyç në trajtimin e krizave ndërkombëtare. Ky është një realitet që nuk mund të anashkalohet nga asnjë aleancë e re apo e vjetër në arenën gjeopolitike.

Nuk mund të ketë reformësim të rendit botëror pa praninë e Kinës në tryezë. Politika e saj e jashtme e ndërtuar mbi parime si respekti për sovranitetin, bashkëjetesa paqësore dhe përfitimi i ndërsjellë nuk është vetëm retorikë; ajo pasqyron përvojën historike të një shteti që ka vuajtur ndërhyrjet e huaja dhe tani kërkon të ndikojë përmes platformave multilaterale. Iniciativat si “Një Brez, një Rrugë” (BRI), Iniciativa për Zhvillim Global dhe roli aktiv në BRICS dhe SCO janë dëshmi e kësaj qasjeje përfshirëse.

Takimi Trump–Putin, ashtu



siç është parashikuar, nuk përfaqëson një *Jaltë të re*, por një rinegociim dypalësh i interesave ruso-amerikane – veçanërisht në raport me Ukrainën. Në këtë skenar, Ukraina nuk trajtohet si një realitet sovran, por si një pikë në hartë për të cilën negociohet në mungesë të saj.

Për më tepër, ky takim nuk jep sinjale për një rend të ri shumëpalësh apo për një angazhim të përbashkët për paqe dhe stabilitet. Pa një përfshirje të barabartë të Europës dhe pa Kinën në tavolinë, çdo përpjekje për të ndarë sferat e influencës përbën një rikthim në logjikën e shekullit XX – jo një hap përpara në ndërtimin e një bote të re. Siç theksonte edhe Kissinger, *“paqja nuk është e mundur pa fuqitë e mëdha, por nuk është e qëndrueshme nëse përjashton aspiratat e të tjerëve.”* Një takim që përjashton Europën, Kinën dhe vetë Ukrainën nuk mund të ndërtojë stabilitet afatgjatë.

A po humbet Trump një mundësi historike?

Në vend të një takimi të mbyllur me prapavijë strategjike dhe synime të dyshimta, Trump mund të kishte marrë iniciativën për një konferencë globale, një “Yaltë e Alaskës” ku të gjitha fuqitë e

mëdha të uleshin si të barabarta për të diskutuar sfidat e shekullit XXI: sigurinë, teknologjinë, ndryshimet klimatike dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Një tryezë ku ulen SHBA, Rusia, Kina dhe një përfaqësim real i Europës do të ofronte jo vetëm legjitimitet, por edhe shpresë për një botë më të drejtë dhe më të sigurt. Pa këtë përmasë gjithëpërfshirëse, çdo takim rrezikon të mbetet një pingpong diplomatik, i shkëputur nga realitetet dhe nevojat e kohës. Bota e sotme është më e ndërlikuar, më e ndërvarur dhe më shumëpalëshe. Fuqitë në zhvillim kërkojnë dinjitet, popujt kërkojnë paqe dhe bota ka nevojë për bashkëpunim, jo për ndarje të reja. Një rend i ri global nuk mund të ndërtohet mbi negociata të fshehta dhe marrëveshje të njëanshme, por mbi pjesëmarrje të barabartë dhe transparencë.

Nëse Trump aspiron të hyjë në histori si një arkitekt i rendit të ri botëror, ai duhet të shohë përtej logjikës së sferave të influencës dhe të ndërtojë një platformë gjithëpërfshirëse. Sepse pa Kinën, pa Europën dhe pa respekt për sovranitetin e kombeve të vogla, nuk ka *Jaltë 2.0* – ka vetëm një përsëritje të gabimeve të së shkuarës.

Kina **ME** Rusinë dhe Europa **PA** SHBA-të!

Nga DR. JORGJI KOTE

Mjeshtër i Madh

Sapo rihyri në Zyrën Ovale në Shtëpinë e Bardhë, Presidenti Trump filloi një lëvizje të re madhore diplomatike. Në fakt, ajo ngjet me hapjen epokale që Administrata e Presidentit Nikson bëri me Kinën në fillimin e viteve 70; e cila kulmoi me vizitën e tij më 21 – 28 Shkurt 1972 në Pekin, ku u prit dhe nga Kryetari Mao. Ishte vizitë vërtet historike, sepse çeli një epokë të re në marrëdhëniet midis dy vendeve, me efekte dhe rrjedhoja të mëdha në gjeopolitikën botërore. Për rrjedhojë, SHBA-të realizuan synimin e tyre strategjik të ndarjes së Kinës nga Bashkimi Sovjetik. Më tej, ato vijuan më me efektivitet luftën e mëtejshme ndaj BS-së, sidomos në vitet 80 me “Lufta e Yjeve” deri në shpërbërjen e Perandorisë Sovjetike më 1991.

Duket qartë se Presidenti Trump po kërkon të bëjë të njëjtën gjë tani por në anën tjetër; pra tani të ndajë Rusinë nga Kina, në mënyrë që ta ketë më të lehtë kontrollin mbi botën, në konkurrencë me ato dy vende. Për pasojë, Rusia le të bëjë çtë dojë në “zonën e vet të influencës së dikurshme” në Europë. Ndërsa kjo e fundit, sipas Trump, le t’i dalë zot vetë vhetes, t’i konsiderojë histori 80 vitet si aleatë dhe partnerë të pandarë strategjikë vlerash, parimesh dhe interesash të gjithanshme!

Mirëpo shqetësimi është se kjo ndarje e re e “zonave të influencës”, që synon SHBA-të bën që dhe Rusia të zbatojë synimin e



saj gjeostrategjik, për ta ndarë më në fund Europën nga SHBA-të, që Moska t’i ketë duart e lira për synimet e saj të mëtejshme për rikthimin e Bashkimit Sovjetik.

Kësisoj, nga njera anë kemi SHBA-të që duan të ndajnë çiftin gjeopolitik tradicional Kinë – Rusi dhe nga ana tjetër Rusinë, e cila synon të ndajë SHBA-të nga Europa, duke i dhënë një goditje të rëndë aleancës së suksesshme historike perendimore. Pyetja madhore këtu është se sa i mundur është realizimi i këtyre dy objektivave strategjikë, apo i njerit prej tyre dhe nëse është kështu, cili më konkretisht?

Pa dashur të mbajmë pezull lexuesit dhe ndjekësit tanë, le ta themi qysh në fillim se mendimi i shumicës dërmuese të politologëve, ekspertëve dhe diplomatëve të njohur dhe i imi është se SHBA-të nuk mund ta ndajnë dot më Kinën nga Rusia; sepse kjo do të ishte sikur “t’i hysh detit e ta kalosh me këmbë”!

Ndërsa objektivi rus për ta ndarë

Europën nga SHBA-të, që deri në janar të këtij viti dukej gjithashtu i pamundur, tashmë po shfaqet si realitet gjeopolitik. Vetëm se kjo i dedikohet kryesisht, për të mos thënë tërësisht doktrinës së re transaksionaliste të Presidentit Trump, e cila vendos mbi gjithçka fitimin, duke hequr dorë nga vlerat dhe parimet Euro-Atlantike e për pasojë dhe nga Europa.

Dhe prapë, për të mos e ngarkuar lexuesin me teorizime akademike boshe, për t’u bindur për këtë parashikim realist gjeopolitik, më poshtë po bëjmë një krahasim të aktorëve dhe faktorëve politikë, diplomatikë dhe ushtarakë të 5 dekadave të fundit.

Për ta filluar, SHBA-të e kishin shumë më të lehtë ta ndanin Kinën nga Rusia në vitet 70, mbasi ato kishin vetëm Bashkimin Sovjetik kundërshtar politik, ideologjik dhe ushtarak. Ndërsa Kina nuk ishte superfuqi dhe as nuk synonte një gjë të tillë; si Muri i Madh ajo ishte në pozita mbrojtëse, pa kapacitetet dhe fuqinë

politike, ekonomike dhe ushtarake të sotme. Rikujtojmë se Kina u pranua në OKB dhe me mbështetjen e vendit tonë në vitin 1973.

Edhe Bashkimi Sovjetik i atëherëshëm ishte i dobësuar. Vërtet që në Gusht 1968 ai pushtoi Çekoslovakinë, por gjithsesi Praga ishte nën sferën e tij të influencës. Pra, BS-ja nuk u fut në fushën kundërshtare, si sot Rusia me Ukrainën, kur kjo e fundit ka shpallur me kohë orientimin e saj pro-perendimor si shtet i pavarur dhe sovran.

Më tej, vitet 70 ishin epoka e Detantës dhe Bashkëkzistencës Paqësore midis dy sistemeve të kundërta politike dhe shoqërore; ishte në prag të përfundimit lufta në Vietnam. Në vitin 1971 Kancelari nobelist gjerman Willy Brandt lançoi “Ostpolitik-ën” e famshme; duke dalë kundër ndryshimit me forcën e armëve të rregjimeve komuniste lindore, Ostpolitik synonte “ndryshimin nëpërmjet afrimit” me marrëveshje bashkëpunimi në të gjitha fushat.

Po ashtu, në vitin 1973 filluan bisedimet në kuadrin e Konferencës për Sigurimin dhe Bashkëpunimin Europian (KSBE) të cilat përfunduan më 1975 me miratimin e Aktit Final të Helsinkit. Me 34 vende anëtare, OSBE-ja siç u quajt në vitin 1995 ishte dhe mbetet organizata më e madhe e këtij lloji dhe e vetmja që mundësonte dialogun midis SHBA-ve dhe BS-së, midis Perëndimit dhe Lindjes. Për rrjedhojë, Ostpolitik dhe OSBE-ja jo vetëm nuk synonin apo ndikonin mbi ndarjen e Europës nga SHBA-të, por ato e forcuan dhe më tej aleancën perendimore deri në shembjen e kampit lindor evropian dhe Murit të Berlinit më 9 Nëntor 1989.

Ndërsa sot po ndodh e kundërta. Me përjashtim të NATO-s dhe deri diku të BE-së, OSBE-ja, KiE-ja dhe organizatat e tjera nuk po pyeten më pothuajse fare, as nga Kina me Rusinë por dhe as nga SHBA-të; madje këto të fundit po dalin jashtë disa organizatave të njohura ndërkombëtare si UNESCO, OBT-ja, OBSH-ja, etj; gjithashtu ka një përshkallëzim të ekstremizmit të djathtë, të populizmit dhe azilit të paligjshëm që kanë dobësuar ndjeshëm Europën dhe kohezionin e saj social.

Gjithsesi, faktori përcaktues që po ndikon mbi forcimin e binomit gjeopolitik Kinë – Rusi dhe nga ana tjetër ndarjen e Europës nga SHBA-të është lufta që vazhdon prej 45 muajsh midis Rusisë dhe Ukrainës, konflikti i ndezur në Lindjen e Mesme, kërcënimi bërthamor i Iranit dhe Koresë së Veriut e deri në Ballkan me kërcënimet serbe ndaj Kosovës. Ku SHBA-të, megjithë fuqinë e tyre ushtarake nuk mund t’i zgjidhin të vetme këto konflikte, mbasi tani nuk janë dhe nuk mund të sillen më si më parë, dmth si “xhandar/polic ndërkombëtar”. Ndërkohë, po shihet qartë forcimi i bashkëpunimit Kinë – Rusi dhe SHBA-Rusi, duke e spostuar Europën.

Dukuria tjetër intriguese ishte se atëhere Kina dhe Rusia nuk kishin aleanca të gjera shtetesh dhe grupimesh si sot, sidomos BRICS+, ku të dyja vendet janë lidere të tij me antarësi në rritje; nga 5 vende anëtare në vitin 2009 kur u krijua tani janë 11 shtete dhe me kërkesa për zgjerim të mëtejshëm. Pavarësisht nga problemet dhe sfidat që ka, BRICS po i shkakton jo pak “dhimbje koke” SHBA-ve dhe Europës, Perëndimit në përgjithësi; vendet e Bricks po kërkojnë më shumë vend dhe hapësirë në forumet

më të larta ndërkombëtare deri në OKB si dhe zëvendësimin e rendit të sotëm një polar me atë shumëpolar. Mirëpo shumë prej atyre vendeve të cilat atëhere kishin lidhje të ngushta ose ishin më tepër vasalë të SHBA-ve dhe të Europës, sot po u kundërvihen hapur këtyre të fundit. Ca më tepër këto po ndodhin në kohën kur uniteti SHBA-Europë po përthyeret.

Ndërkohë, vlen të theksohet se vërtet që SHBA-të ia dolën në vitet 70 të bënin hapjen e madhe ndaj Kinës; por kjo u bë në mirëkuptim dhe bashkërendim me aleatët e saj evropianë, pa krijuar asnjë lloj konflikti dhe krisje. Për rrjedhojë, Nikson shkoi në Pekin me një bazë dhe mbështetje të fuqishme Euro-Atlantike. Ndërsa sot kanë dalë sheshit grindjet dhe ndarjet SHBA – Europë, pavarësisht se Europa me diplomacinë dhe koreografinë e saj brilante në Samitet e Hagës, të Uashingtonit dhe gjetkë po bën çmos për t’i mbajtur sa më gjatë SHBA-në në “vathën” Euro-Atlantike.

Shkak tjetër i rëndësishëm se pse sot SHBA-të nuk e ndajnë dot Kinën nga Rusia, ndërsa kjo e fundit e ndan atë nga Europa është se atëhere SHBA-ja kishin diplomaci shumë më efektive se kjo e sotmja; në atë kohë në krye të saj ishte Henry Kissinger, “Mbreti” i pazëvendësueshëm i diplomacisë, të cilin nuk mbeti lider në botë pa e telefonuar dhe pa i kërkuar mendim deri sa dha frymë në moshën 100 vjeçare. Kissingeri emblematik ishte arkitekti i hapjes epokale ndaj Kinës, themeluesi dhe praktikuesi i papërsëritshëm i diplomacisë së ecejakeve (shuttle diplomacy), ndërmjetësuesi i jashtëzakonshëm dhe personalitet me jehonë të madhe publike. Në rastin e Kinës, krahas dimensionit klasik, ai zbatoi me shumë suk-

ses dhe të ashtuquaturën ”diplomaci të pingpongut“. Në kuadrin e saj, ecejaket e Kisingerit dhe vizita historike e Niksonit në Pekin u papraprinë nga ndeshje basketbolli në Pekin dhe më pas në Uashington midis ekipeve kombëtare të Kinës dhe SHBA-ve. Me parë ishte e paimagjinueshme të luaje në publik me “armiqtë më të mëdhenj” dhe të bëheshe mik me ta! Ato ndeshje patën një ndikim tejet pozitiv në përgatitjen e opinionit të gjerë publik në të dy vendet, në krijimin e një klime mirëkuptimi dhe besimi të ndërsjellë, duke sfiduar dhe shmangur shumë tabu dhe paragjykime. Aq e efektshme ishte kjo diplomaci sa lojtarët e të dy ekipeve kane vijuar ndeshjet vjetore midis tyre dhe tani deri vonë, duke i kthyer ato në traditë të bukur publike. Kësisoj, basketbollistët e tyre u bënë “ambasadorët” më të mirë, çka e pohonte dhe vetë Kryetari Mao.

Mirëpo, ndryshe nga 5 dekada më parë, sot SHBA-ve i mungojnë në radhë të parë kryediplotatë të tillë kalibri si Kisinger, Ambasadori i ndjerë Richard Holbrooke e të tjerë. Ndërsa diplomaci si ajo e ping pongut dhe në përgjithësi diplomacia publike, e kulturës dhe e sharmit në SHBA jo vetëm nuk ka të krahasuar me atëhere, por për fat të keq po fshihen institucionet dhe gjurmët e saj mbresëlënëse.

E kundërta po ngjet me Kinën dhe Rusinë të cilat kanë diplomaci të thekur dhe me shumë përvojë, të mbështetur tashmë dhe nga fuqia propagandistike, ekonomike dhe ushtarake. Kjo u pa së fundi dhe në Samitin e Alaskës, ku Trump shoqërohej nga Rubio, Heseth dhe Witkoff, personalitete pothuajse anonimë; ndërsa Putini nga “Dekani” i ministrave të jashtëm të botës Sergei Lavrov; “kiji in-

Me mbështetjen kineze, Rusia vazhdon luftën kundër Ukrainës dhe me synime përtej saj, si pjesë e strategjisë së saj për të rikrijuar Perandorinë e dikurshme cariste apo sovjetike, për ta zëvendësuar “forcën e ligjit me ligjin e më të fortit”, duke goditur dhe çmontuar rendin e sotëm ndërkombëtar në favor të një rendi të ri multipolar, pa dominim të SHBA-ve dhe me aleanca të përkohshme interesash!

atin, por foli hakun“, ka 21 vjet në atë post, i ka kaluar të gjitha shkallët e shërbimit diplomatik, ish ambasador në OKB për 10 vjet, me të cilin duhet të mendohesh dhe të përgatitesh mirë kur të flasësh; në Alaskë ishte dhe këshilltari më i afërt i Putinit, ish Ambasador në Uashington, Oshtakov, të dy me anglishte perfekte dhe njohës brilantë të SHBA-ve, Europës dhe gjeopolitikës.

Edhe Europës i mungojnë sot liderë dhe kryediplotatë të vërtetë dhe bashkues interkontinentalë si Genscheri emblemantik, Brandt i Ostpolitik-ës, Vredrine, Solana, etj. Mungesa e lidhshimit elitare diplomatik në Europë ia lehtëson goxha misionin Rusisë për ta ndarë Europën nga SHBA-të dhe ia vështirëson kësaj të fundit synimin e saj për ta ndarë Rusinë nga Kina.

Po ashtu, në vitet 70 SHBA-të kishin filluar zbatimin në shkallë të gjerë të të ashtuquajturës ”diplomaci e butë“ (soft diplomacy) e cila ka shërbyer deri tani si një model me shumë efekte për të gjitha diplomacitë e vendeve të tjera. Madje deri vonë, në Departamentin Amerikan të Shtetit

kishte një drejtori të madhe dhe një Zv.Sekretar Shteti që mbulononte diplomacinë publike, e cila është hequr në kuadrin e shkurtimeve masive diplomatike. Institucione të tilla prestigjioze si USAID, Zëri i Amerikës, programet e studimit Fullbright, xhazi, muzika, Harvardi ishin mbështetje e fuqishme e diplomacisë klasike amerikane. Lidhur me këtë temë, Ambasadori dhe publicisti indian me famë ndërkombëtare, Keshan S. Rana thotë se “shumë pak amerikanë e vlerësojnë se sa shumë ndikuan në rënien e komunizmit dijet mbi SHBA-të dhe në veçanti roli i Zërit të Amerikës“. Mirëpo ishin pikërisht këto institucione kult që muajt e fundit u mbyllën, duke habitur dhe vetë diktatorët që ngritën dollin me shampanjë për Presidentin Trump që i heshti ato. Dukuria tjetër sfiduese dhe shqetësuese për synimin e lartpërmendur të SHBA-ve është se pavarësisht demarsheve të shumta diplomatike, Kina jo vetëm nuk heq dorë, por ajo është betuar për të vazhduar mbështetjen e gjithanshme, sidomos atë ushtarake ndaj Rusisë dhe në luftën ndaj Ukrainës si aleate të përhershme, çka është vulosur dhe në traktatet dypalëshe mes tyre.

Me mbështetjen kineze, Rusia vazhdon luftën kundër Ukrainës dhe me synime përtej saj, si pjesë e strategjisë së saj për të rikrijuar Perandorinë e dikurshme cariste apo sovjetike, për ta zëvendësuar “forcën e ligjit me ligjin e më të fortit”, duke goditur dhe çmontuar rendin e sotëm ndërkombëtar në favor të një rendi të ri multipolar, pa dominim të SHBA-ve dhe me aleanca të përkohshme interesash!

E kundërta po ndodh me SHBA-të, të cilat praktikisht po heqin dorë nga aleanca me BE-në dhe

Europën në përgjithësi, duke i kushtuar përparësi Ruisë dhe Kinës, ku duket se nevojat, interesat dhe fitimet e saj mund të jenë më të mëdha.

Për pasojë, Europa dhe BE-ja po nxitojnë për europeanizimin e NATO-s, për të dhënë deri në vitin 2035 nga 2 aktualisht në 5 për qind të GDP-së; të gjitha këto me qëllim që Europa të kthehet në një bashkim të madh mbrojtës, ME dhe PA Amerikën, pra krejt ndryshe nga Rusia me Kinën që janë dhe do mbeten bashkë.

Nga ana e vet Kina nuk ka asnjë interes të prishet me Rusinë e kësaj të dalë Amerika më e fituara. Pekini synon që bashkë me Rusinë dhe aleatë të tjerë, kundrejt një Europë të dobësuar dhe pse jo të ndarë më në fund nga SHBA-të, të konkurojnë dhe t'i mposhtin përfundimisht SHBA-të në të gjitha fushat.

Pastaj, interesat, nevojat dhe përfitimet gjeopolitike dhe ekonomike të Kinës me Rusinë dhe anasjelltas janë aq të mëdha, sa vërtet që nuk ka Zot t'i ndajë nga njera tjetra. Ndërsa aleanca perendimore e sidomos ajo SHBA-Europë, siç po ecin gjërat, mund të prishet shumë shpejt. Madje qysh tani mund të thuhet se marrëdhëniet mes tyre nuk janë më ato tradicionalet, si aleatë dhe partnerë të nguihtë strategjike, por më tepër si partnerë ekonomikë dhe tregtarë ose dhe aleatë fare të përkohshëm dhe të pjesshëm, si bie fjala për rastin e Ukrainës, por jo më si 80 vitet e fundit.

Ja pse të kërkosh sot që ta ndash Rusinë nga Kina mbetet vetëm “dëshirë e mirë” ndërsa ndarja e Europës nga SHBA-të tani duket thjesht çështje kohe. Dhe kjo falë politikës dhe diplomacisë zbutëse dhe përkëdhelëse të Uashingtonit ndaj Moskës, e cila kështu “po e

merr kalanë europiane nga brenda” nëpërmjet Uashingtonit, pa ndonjë mundim dhe sforcim të madh. Siç pohojnë shumë analistë, favorët dhe lehtësitë politike, ekonomike dhe diplomatike që i ka krijuar SHBA-të Moskës nuk do të ishin realizuar dot nga propaganda e saj.

Veç sa sipër lidhur me Europën, dallim tjetër i madh me 4 – 5 pesë dekada më parë është se atëhere ajo kishte në kohezion të madh politik, social dhe diplomatik; ajo ishte në lulëzim dhe nuk kishte forcë, as të brendshme dhe as të jashtme që ta ndante apo dhe përcante. Ndërsa në këto 20 vitet e fundit, pas zgjerimit me 10 vende ish lindore por dhe krizat e konfliktet e shumta, “anija” e BE-së dhe e NATO-s ka kohë që “fut ujë”. Veç problemeve mes aleatëve tradicionalë perendimorë, blloku me katër vende i Visegradit që ishte avangarda e shembjes së komunizmit dhe zgjerimit europian është kthyer në “rebele” e BE-së, duke ndikuar në kohezionin e saj, duke u rreshtuar në favor të SHBA-ve. Me justifikimin se “ne nuk ikëm nga Moska që të binim preh e Brukselit”, siç shprehen ata.

Aleancën e re Amerikano-Ruse e dëshmoi qartë Samiti në Alaskë dhe në Uashington, ku me një fjalë Putini u prit jo si agresor, por si çlirimtar i Ukrainës. Ndërsa Europa e quan Rusinë agresore, Trumpi ka venë shenjën e barazimit absurd midis Ruisë dhe Ukrainës. Ndërsa në Samitin e Uashingtonit, pavarësisht nga koreografia brilante e të 8 liderëve europianë dhe Ukrainës për ta mbajtur Trumpin nga ana e tyre, ajo ishte vetëm aq dhe gjendja shumë shpejt u kthye sërish atje ku ishte në Alaska. Me 3 piksynime madhore paqebërëse por të papajtuësme midis tyre:

SHBA duan thjesht mbarimin e luftës dhe një UJDI me leverdi komerciale për ta, Ukraina dhe Europa duan paqe të vërtetë dhe të qëndrueshme, duke respektuar sovranitetin e Ukrainës dhe integritetin e saj territorial; ndërkohë, krejt ndryshe prej tyre Rusia kërkon jo thjesht paqe, por një paqe me fitoren e saj me çdo kusht dhe me marrje territori; kësaj, ajo paqe do të jetë pushtim i ri ose kapitullim i Ukrainës dhe bashkë me të dhe i Europës.

Mirëpo ky raport i kthyer përmby, kur aleanca kino-ruse do të lulëzojë, ndërsa ajo Atlantike do të kalojë ditë të këqia krijon një disavantazh të madh gjeostrategjik për SHBA-të dhe ca më shumë për Europën. Pikërisht këtë avantazh po shfrytëzon Rusia dhe bashkë me të dhe Kina, duke “luajtur me dy porta”. Mbi të gjitha, me synimin për përmbyshjen e arritjes së madhe historike, shembjen e Murit të Berlinit dhe të komunizmit në Europën Qendrore dhe Lindore dhe ribashkimin europian.

Ja pse përfundimisht, synimi amerikan për ta ndarë Rusinë nga Kina nuk ka asnjë shans të fitojë. E kundërta po ndodh me synimin rus për t'i ndarë SHBA-të nga Europa që po kthehet përditë e më shumë në një realitet të trishtë. Mirëpo kjo është e mbarsur me rreziqe dhe pasoja të rënda, jo vetëm për Europën por dhe për vetë SHBA-të. Këtu vlen paralajmërimi i ish Komandantit të NATO-s për Europën më 2014 – 2017, gjeneralit amerikan Ben Hodges se SHBA-të nuk mund t'ia dalë e vetme në përballimin e sfidave madhore gjeopolitike dhe ushtarake; ajo do të ketë detyrimisht nevojë për aleatë dhe përvoja e 80 viteve të fundit tregon se aleatja më e besueshme e SHBA-ve është Europa Perendimore!

PSE “HESHT” KINA?

Nga Prof. Dr. ENVER BYTYÇI

Prej kohësh, pra prej muajsh, zhvillohen debate rreth luftës në Ukrainë dhe asaj në Gaza. Ndodhën sulme ushtarake të Izraelit kundër Iranit si dhe një bombardim amerikan kundër këtij vendi. U takuan presidentët Trump dhe Putin në Alaska, si dhe u bënë takime të përbashkëta në Shtëpinë e Bardhë të udhëheqësve evropianë me presidentin amerikan. Ka gjithë ato ecejake diplomatike në kërkim të paqes. Ndërkohë Pekini hesht. Thuajse asnjë fjalë nuk thuhet prej kohësh nga ana e udhëheqësve kinezë. Pse po ndodh diçka e tillë? Si është e mundur që Fuqia e dytë më e Madhe e globit të jetë kaq indiferente, megjithëse mediet dhe eksponentë të ndryshëm nuk lanë rast pa e akuzuar Republikën Popullore të Kinës, se ajo dëshiron të pushtojë Tajvanin dhe të krijojë një vatër të re konflikti në Azi?

Nëse qëndrojmë për pak kohë dhe hedhim një vështrim nga historia e diplomacisë kineze, atëherë vëmë re se karakteristika themelore e kësaj diplomacie në traditë është durimi, mënjanimi i pasioneve dhe emocioneve politike në deklaratimet dhe veprimtarinë diplomatike. Kjo karakteristikë në fakt buron prej filozofisë së Konfucit, filozofi e cila është burim orientimi edhe për politikën e diplomacinë e sotme kineze. Duke hulumtuar për marrëdhëniet shqiptaro-kineze në vitet 1960-1970 kam vënë re qetësinë “e frikshme” dhe një lloj sinqeriteti të pazakontë në komunikimet midis psh Çu En Lait dhe



udhëheqësve komunistë shqiptarë. Nuk kam mundur të gjej ndonjë mospërputhje midis realitetit dhe pohimeve diplomatike të përfaqësuesve të Kinës, ndërkohë që kam gjetur jo pak mospërputhje në qëndrime e pasinqerta të lidershit të Tiranës komuniste. Kjo është një nga arsytet pse sot Republika Popullore e Kinës qëndron në një anë dhe nuk përfshihet as në zgjidhjen e konflikteve të rrezikshme të kohës së sotme.

Është e vërtetë se qeveria dhe presidenti kinez kanë interesa të ndryshme në zona dhe rajone të ndryshme në botë. Pjesë e përpjekjeve për të garantuar interesat e tij janë edhe marrëdhëniet me Rusinë dhe disa vende të tjera. Një fuqi kaq e madhe dhe e zhvilluar, nuk ka sesi të mos jetë e interesuar për zhvillimet që ndodhin, sidomos në Ukrainë dhe në Gaza. Gjithashtu nuk ka se si të mos përpiqet të investojë dhe zhvillojë marrëdhënie tregtare dhe ekonomike me vende e rajone të ndryshme të globit. Por më sa duket Pekini mendon që një angazhim aktiv i tij në politikën globale nuk i ndihmon zgjidhjes së konflikteve, sepse do të shihej me xhelozë dhe si përpjekje e tij për dominim politik në planin global.

Ndaj dhe presidenti Xi ose kryeministri apo ministri i Jashtëm kinez nuk kanë shprehur pretendime për t’u bërë qoftë dhe formalisht pjesë e zgjidhjes. Kjo lidhet njëkohësisht me karakterin e lidershit kinez, i cili nuk vuan nga mania për preshtigj.

Nga ana tjetër, Republika Popullore e Kinës është shprehur se respekton rendin e sotëm global. Dhe në këtë kuadër ajo është deklaruar edhe për një zgjidhje në Ukrainë, ku të ruhej integriteti territorial i saj. Ajo nuk e ka njohur pushtimin rus të Krimesë. Megjithatë Pekini nuk ia jep të drejtën vetes të ndërhyjë në zgjidhjen e këtij konflikti. Qëndron krejt indiferent dhe në këtë indiferentizëm reflekton fuqinë e sigurinë e tij. Ndërkohë që vende të tjera, sidomos Franca e Macron, janë të alarmuar, Kina jep leksionin se gjithçka është e mundur në rrugën e zgjidhjes së konflikteve të sotme. Duke respektuar rendin e sotëm botëror Pekini reflekton gjithashtu qëndrueshmëri dhe gjithashtu besim më të madh te popujt, sidomos te kombet e vegjël. Kjo strategji është për lidershipin kinez më e rëndësishme se sa fitorja e ndonjë beteje ushtarake.

Vuçiçi po e shtyn Serbinë drejt një konflikti civil



Nga Andrej Ivanji-Vreme[i]

Aleksandër Vuçiçi po e shtyn Serbinë në konflikt të përgjithshëm civil. Mostoleranca mes pjesës së revoltuar të shoqërisë dhe atyre që mbrojnë pushtetin ka arritur në nivelin e gatishmërisë për përplasje fizike. Kjo mund të shihet edhe gjatë shumë takimeve të afërta të qytetarëve të grumbulluar në tubimet studentore nga njëra anë, dhe qytetarëve të grumbulluar përreth Partisë përparimtare serbe (PPS) në pushtet në anën tjetër. Kjo u pa qartë të martën para ish qendrës tregtare “Mercator”, në të cilën njësitë e kombinuara të Xhandarmerisë

dhe brigadave policore të përparimtarëve dhe ata që nuk janë të tillë, mezi i ndanë për të mos i'u turrur njëri tjetrit. Njëra palë të zemëruar erdhën të protestojnë, të tjerët, me komandë, për të treguar se përparimtarët janë të gatshëm për luftë për mbrojtjen e presidentit të tyre. Natyrisht jo për vuçiçevistët, por për Vuçiçin. Rregjimi i Aleksandër Vuçiçit e ka kaluar zenitin e tij. Pushteti që ka hyrë në konflikt frontal me djemtë, mësuesit e shkollave të mesme dhe studentët, me profesorët e universiteteve nuk ka të ardhme. Përpjekja për disiplinim të atyre të cilët në kuptimin e vërtetë të fjalës janë e adhmja e këtij vendi dhe të atyre që i përgatisin dështoi. Pushteti i PPS-së, pjesën

më të arsimuar të shoqërisë e quan terroristë-blokues, mercenarë, armiq të shtetit.

Vuçiçi i cili është kthyer në rrënjët shesheliane e sheh rrugëdaljen vetëm në përdorimin e metodave radikale. Duke amnistuar përdoruesit e shkopinjve të cilët një studenteje i thyen nofullën dhe atë vajzën e cila shkeli me makinë një studente sepse po protestonte kundër presidentit të shtetit, i zhytur kokë e këmbë në idenë se Çaçilendi është forca e shtetit, provokon me qëllim qytetarët e revoltuar duke shkaktuar konflikt i cili më pas mund të ofrojë justifikim për ndërhyrje masive dhe brutale të policisë.

Si njëherë e një kohë Vojislav Shesheli i cili tundte pistoletën.

Kush është i zoti i shtëpisë.

Autoriteti i Vuçiçit brenda sistemit të tij ka nisur të dobësohet dhe grimcohet, rrudëdaljen e sheh në atë që të tregojë se cili është i zoti i shtëpisë që vendos për fatet e njerëzve, ndërsa besnikët e tij nuk do t'i lërë në mëshirë të fatit.

Ky është mesazh i rëndësishëm në kontekstin e hetimit të Prokurorisë speciale për kriminalitetin e organizuar (TOK) për korrupsionin i cili çoi në rënien e tarrasës së stacionit hekurudhir në Novi Sad. Disa policë ishin të gatshëm të arrestonin të dyshuarit ku bënte pjesë edhe ish ministri dhe antari i kryesisë së PPS-së, Tomislav Momiroviç, ku më pas i'u

caktua burgimi. Ish ministri tjetër dhe antar i kryesisë së PPS-së, Goran Vesiq për shkak të problemeve shëndetsore nuk është akoma në burg.

Dikur ndoshta do të tregohet i gatshëm të këndojë që të shpëtojë lëkurën e vet.

Akuza e TOK është shtizë e ngulur në shtyllën kurrizore të sistemin të pushtetit të përparimtarëve. Përgjigja e njerëzve nga kreu i partisë shtet është e njëjta si në rastin e revoltave të shkollave të mesme, mësuesve dhe profesorëve, tani, hetuesit e gjykatësit dhe një pjesë e policisë shpallen tradhëtarë dhe armiq të shtetit. Sepse hapi tjetër mund të jetë hetimi për

Aleksandër dhe Andrej Vuçiçin.

Sistemi është çarë


Qytetarët e revoltuar nëpër rrugë, studentët e revoltuar në fakultete, mësuesit në sistemin arsimor, hetuesit dhe gjykatësit e revoltuar, një pjesë e xhandarëve të trajnuar për përplajse me kriminelë të rrezikshëm dhe terroristë janë të revoltuar sepse i dërgojnë që të përplasen me fëmijët – sistemi është çarë. Se deri në çfarë mase, këtë e tregoi programi në TV Informer pas informacionit që Darko Glishiçi ka pësuar hemoragji cerebrale: Dragan J. Vuçiçeviçi dhe ekipi i tij e shfrytëzuan këtë situatë që nga mëngjezi deri në darkë të rrahin gjkosin për larje hesapesh me rrugaçët, plehrat, jashtëqitjet, njerëzit e egër, ustashët serbë – terroristët bllokues që po shkatërrojnë Serbinë dhe serbizmin.

Nga njëra anë mungesa e ligjit, kleptokracia, joformaliteti, foddullëku dhe njerëzit e gatshëm për t'i mbrotjur këto deri në fund, në anën tjetër kërkesa për shtetin e së drejtës dhe vendosjen e normalitetit dhe njerëzit e vendosur që të mos lëvizin më para dhunës dhe dhunuesve.

E vetmja mënyrë e paqtë për daljen nga kriza politike dhe e sistemit janë zgjedhjet parlamentare të parakohëshme. Por përdërisa anketuesit e opinionit publik thonë se Partia përparimtare serbe, me gjithë manipulimet e mundshme, nuk mund të sigurojë fitoren, ato nuk duken askund. Ndoshta shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme.

[i] <https://vreme.com/komentar/gradjanski-sukobi/>
/Përktheu për Argumentum
Xhelal FEJZA

Ky është mesazh i rëndësishëm në kontekstin e hetimit të Prokurorisë speciale për kriminalitetin e organizuar (TOK) për korrupsionin i cili çoi në rënien e tarrasës së stacionit hekurudhir në Novi Sad. Disa policë ishin të gatshëm të arrestonin të dyshuarit ku bënte pjesë edhe ish ministri dhe antari i kryesisë së PPS-së, Tomislav Momiroviç, ku më pas i'u caktua burgimi. Ish ministri tjetër dhe antar i kryesisë së PPS-së, Goran Vesiq për shkak të problemeve shëndetsore nuk është akoma në burg.



Fitoret taktike në bisedimet e paqes në Ukrainë do të çojnë vetëm në humbje strategjike



Nga Tatiana Stanovaya*

Samiti midis Presidentit të SHBA-së Donald Trump dhe Presidentit rus Vladimir Putin në Alaska dhe takimi pasues i presidentit të SHBA-së me homologun e tij ukrainas Volodymyr Zelensky dhe udhëheqësit evropianë në Uashington kanë dhënë shpresa të reja se fundi i luftës Rusi-Ukrainë mund të jetë më në fund afër. Në fund të fundit, për herë të parë në disa vite, palët kanë filluar të diskutojnë parametrat praktikë të një zgjidhjeje.

Megjithatë, në realitet, perspektivat afatgjata të negociatave nuk

kanë ndryshuar vërtet. Pjesëmarrësit mund të pretendojnë me të drejtë suksese të caktuara taktike, por strategjikisht, ka vetëm më shumë humbje në dispozicion.

